



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "NAZMI RUSHITI" PESHKOPI

Adresa: Lagjia "Nazmi Rushiti" Sheshi "Demokracia" tel. 0210223400; e-mail: ar.profesionale@yahoo.com

NJOFTIM

Nr. 84 prot

Peshkopi më: 26 / 12 / 2023

Lënda: Njoftim për vend të lirë

Drejtuar: DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të Ligjit nr.15 /2019, "Për nxirjen e punësimit ; të ligjit nr.15 / 2017 " Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554 datë 31.07.2019 " Për Krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të Udhëzimit nr. 14, datë 27.5.2021 " Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit"

Ofruesi publik i AFP - së - shkolla e mesme profesionale " Nazmi Rushiti " Peshkopi, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin – përgjegjës i sektorit financë administrim.

Për personelin mbështetës

1 – Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon ;

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar,
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën,
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale,
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar,
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit,
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

2 – Kriteret e posaçme për përgjegjësin e sektorit financë administrim si vijon :

- a) të ketë diplomë studimi të ciklit të dytë shkencë ekonomike ose diplomë universitar të ekuivalentuar me të,
- b) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë në profesion, sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës,
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dosja e aplikimit, e cila përmban

Dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në),
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së,
brenda datës 03 . 01 . 2024.

DREJTORI

Majlinda Poçi

